




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL VII/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) për vitin 2026 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.06.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Merita Basha

z.Zek Berisha

znj.Amira Sofra

z.Aziz Bytyqi

z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Eko-Theranda” Sh.A:

3.Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2026;

4.Të ndryeshme;

Kryesuesja-e hedhë në votim rendin e ditës

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara

Kryesuesja- e hedhë në votim pikën 1

Pika2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Eko-Theranda” Sh.A:

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-përshendetje për të gjithë,unë i kam dy shqetësime në raport nuk po figuron sa është numri i punëtorëve aktualisht,dhe e dyta mënyra e financimit a është 100% që e mbeshtetë Komuna apo ka arrit si Kompani me kriju të hyra të veta me ndonjë kontrat individuale.

Avni Bytyçi-nr i punëtorëve është 17 ,çështja e financimit është 100% nga Komuna për arsye se ndërmarrja ende nuk ka arrit me kriju të hyra vetanake.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3.Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2026;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-unë një pik e pash që u diskutu për rrezikun e madh që është nga qenët endacak dhe nëse dikush ka informata se a ka vepru Komuna në këtë drejtim për ëtë vit?

Avni Bytyçi-është pengesë jo vetëm për Komunën ton por është penges në nivel të Kosovës, kjo informat flet për periudhën Prill-Qershor 2026,është diskutu dhe është rekomandu që Komuna ti merr aktivitetet e veta që të bën trajtimin e qenëve endacak por ende nuk ka fillu.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi; 09:15